

Rreth TB Alert

TB Alert është një shoqatë unike bamirësie, që po rrit ndërgjegjësimin për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e nevojshëm. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën mbi Tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.

Më shumë rreth TB Alert

Nëse keni TB dhe doni të mësoni më shumë rreth tij nga dikush që e ka kaluar këtë sëmundje, ekziston një libër i titulluar "The Tuberculosis Survival Handbook" (Manuali i mbijetesës nga tuberkulozi) nga Paul Mayho (botimi i dytë). Libri kushton 14,95 GBP dhe gjendet në libraritë lokale, te kompania Gazelle e shërbimeve të shpërndarjes së librit dhe te www.amazon.co.uk, ose drejtpërdrejt nga botuesit, në faqen e internetit www.meritpublishing.com të kompanisë Merit Publishing International ose duke dërguar një e-mail në merituk@aol.com. Numri i referencës për të porositur librin është ISBN 1 873413 14 9.

Website www.tbsurvivalproject.org

Mbroni të gjithë familjen dhe miqtë nga TB - merrni ilaçet e TB-së

Mos harroni se Infermierja e tuberkulozit është këtu për t'ju ndihmuar dhe për t'ju këshilluar gjatë të gjithë trajtimit tuaj. Ju lutemi kontaktoni infermieren tuaj të tuberkulozit nëse nuk ndiheni mirë gjatë trajtimit tuaj ose nëse ka ndonjë gjë që jeni të pasigurt për mjekimin tuaj.

Infermierja juaj e tuberkulozit është:

Doktori juaj në spital është:

Nr. i kontaktit:

E-maili:

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



TB Alert,

Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

Informacioni i dhënë në këtë broshurë rreth tuberkulozit rezistues ndaj shumë ilaçeve ka si synim të japë informacion të përgjithshëm rreth subjektit. Ai nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e infermieres/doktorit tuaj të tuberkulozit ose të profesionistëve të tjerë të shëndetësisë. Asnjë nga informacionet që përmban kjo broshurë nuk mendohet të përdoret për të marrë vendime për diagnoza ose për kurim. Pyetjet dhe problemet në lidhje me diagnozën dhe kurimin duhet t'i drejtohen një profesionisti të kujdesit shëndetësor.

Punim origjinal kërkimor nga North West London TB Network

Një kompani e fitimprurëse. Regjistruar në Angli (Nr. 3606528). Nr. i regjistrimit të Bamirësisë: 1071886. Dizajni: worksong, London 020 8352 8300



Gjurmimi i personave të infektuar dhe ekzaminimi për tuberkuloz (TB)

je e madhe
gjatë natës
peraturë!!
e pasqyruar në
shpirtësi e
emperaturë!!
Djersitje e
gjatë natës. Me ose pa kollë
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Largji!! Temperaturë!! Letargji!! Letargji!! Temperaturë!! Letargji!!
Me ose pa kollë Gjëndra të ënjtura
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë
Gjëndra të ënjtura Gjëndra të
Temperaturë!! Humbje e pashpjegueshme në
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë



Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi (TB) është një infeksion bakterial që kryesisht gjendet në mushkëri por që mund të prekë çdo pjesë të trupit. Tuberkulozi është i mjekuashëm nëpërmjet një cikli mjekimi që zgjat zakonisht 6 muaj. Vetëm tuberkulozi i mushkërive ose i fytit mund të jetë infektues dhe pjesa më e madhe e njerëzve nuk do të jenë infektues brenda dy javëve nga marrja e ilaçeve të duhura.

Si merret tuberkulozi?

Kur dikush me tuberkuloz infektues të mushkërive ose të fytit kollitet ose teshtin, mikrobet mund të futen në ajër në formën e pikëzave dhe njerëzit e tjerë mund t'i marrin me anë të frymëmarrjes. Njerëzit që kanë më shumë gjasa që të infektohen me tuberkuloz, janë ata të cilët kanë kaluar një kohë të gjatë pranë personave me tuberkuloz (zakonisht partnerët dhe njerëzit e tjerë brenda një shtëpie ose shumë rrallë kolegët e afërt të punës). Ka shumë pak mundësi që dikush të mund të infektohet me tuberkuloz në vende të tilla, si p.sh. në autobus ose në tren, meqenëse kontakti për disa orë me dikë që është i infektuar, është zakonisht i domosdoshëm për të qenë i rrezikuar nga infektimi. Tuberkulozi nuk përhapet nëpërmjet pështymës ose shkëmbimit të objekteve.

Çfarë është gjurmimi i personave të infektuar dhe ekzaminimi?

Nëse ju keni qenë në kontakt me një person që ka tuberkuloz ngjitës dhe ai është kollitur ose është teshtirë shumë kur ka qenë pranë jush, ju duhet të bëni një kontroll për të përcaktuar nëse ju jeni infektuar ose nëse tregoni simptoma të sëmundjes së tuberkulozit. Kjo është e rëndësishme, sepse mund të jepen këshillat e duhura ose mund të fillohet trajtimi me medikamente nëse është e nevojshme. Duke trajtuar njerëzit që në fillim nëse është e nevojshme, ndihmohet ndalimi i përhapjes së mëtejshme të tuberkulozit.

Kontrolli:

Nevojitet për të përcaktuar nëse ju keni ndonjë simptomë të tuberkulozit, nëse ju jeni vaksinuar më parë me vaksinën BCG (e cila ofron një farë mbrojtjeje kundër tuberkulozit) dhe nëse jeni infektuar me tuberkuloz, por nuk keni shfaqur ende simptoma të kësaj sëmundjeje.

Juve mund t'ju ofrohen një ose më shumë teste, si:

- Një test lëkure i quajtur Testi Mantoux. Ndonjëherë ky test duhet të përsëritet pas 6-8 javësh
- Një analizë gjaku
- Një ekzaminim me rreze-X i gjoksit

Rezultatet e këtyre testeve do të ndihmojnë në përcaktimin e këshillës ose të trajtimit i cili është më i miri për ju.

Ju nuk duhet të habiteni nëse anëtarë të ndryshëm të së njëjtës familje nuk trajtohen saktësisht në të njëjtën mënyrë.

Simptomat që duhen mbajtur parasysht:

- Kollë që zgjat më shumë se tre javë, që nuk reagon ndaj barnave normale dhe përkeqësohet
- Ethe (temperaturë e lartë)
- Djersitje aq e madhe gjatë natës saqë duhet të ndërtoni çarçafët
- Humbje e peshës pa asnjë arsye
- Lodhje (mungesë energjie ose lodhje e tepërt)
- Gjëndra të ënjtura
- Humbje oreksi
- Kollë me gjak (kjo ndodh shumë rrallë, por kërkon këshillim të menjëhershëm mjekësor)

Të gjitha këto simptoma mund të jenë shenja të problemeve të tjera, por nëse ju keni tre ose më shumë prej tyre dhe jeni të shqetësuar, ju duhet të flisni me një doktor ose me një infermiere në ambulancën ose në klinikën lokale.

Çfarë duhet të bëj nëse kam qenë në kontakt me dikë që ka tuberkuloz ngjitës?

Nëse ju keni qenë në kontakt të afërt me dikë me tuberkuloz ngjitës, ju duhet të kontaktoheni nga shërbimi shëndetësor lokal, i cili duhet të caktojë një takim për të bërë kontrollin tuaj. Nëse ju nuk kontaktoheni dhe jeni të shqetësuar, telefonojini klinikës tuaj lokale të dispanserisë ose mjekut të familjes. Nëse mendohet se është e nevojshme, do të caktohet një takim për ju.

A mund t'i vazhdoj aktivitetet e mia të përditshme?

Nuk ka asnjë arsye që të ndërprisni ndonjë nga aktivitetet tuaja të përditshme. Madje dhe nëse ju keni qenë në kontakt me dikë me tuberkuloz ngjitës, mundësia që të zhvillohet infeksioni ose sëmundja e tuberkulozit është e vogël, dhe akoma më e vogël që të keni një tuberkuloz që mund të transmetohet te personat e tjerë. Nuk është e nevojshme të merrni pushim në punë ose në shkollë, përveç rastit kur keni një kollë që ka zgjatur për disa javë ose kur nuk ndiheni mirë. Nëse dyshimi që ju keni një tuberkuloz ngjitës është shumë i fortë, juve do t'ju jepet këshillë nga ekspertët.